



A.nr.186/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj–Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.186/2026 të datës 20.02.2026 të parashtruar nga ankuesja E.P, nga Vushtrria, kundër organit të punësimit: Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.07.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.186/2026, e datës 20.02.2026, e parashtruar nga ankuesja E.P.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 5466/26, i datës 04.02.2026, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, lidhur me shpalljen e kandidatëve të suksesshëm në procedurën e pranimit me numër të referencës RN000189609.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil E.P, (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), më datë 20.02.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër për procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018969, gjegjësisht për pozitën e punës “*Zyrtar për Invalidë të Luftës dhe Familje të Dëshmorëve*”, të shpallur nga Komuna e Prishtinës më datë 07.11.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vushtrrisë, ndërsa kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) **administroi këto prova**: Ankesën me numër protokolli 898/2026 të datës 20.02.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Kopjen e Konkursit; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe akt

emërimet; Lista e kandidatëve pjesëmarrës; Dosjen e ankueses dhe kandidatëve fitues; Testin me shkrim të kandidatit fitues; Rezultatet e testit me shkrim; Formularët e vlerësimit për intervistën me gojë, nga secili anëtar i Komisionit; Rezultatet përfundimtare të kandidatëve; Vendimin me numër protokolli 0515/26 të datës 06.01.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; Njoftimin me numër protokolli 5466/26, i datës 04.02.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, prova shtesë të datës 27.07.2026.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuar, *sepse*:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezultojnë:

- Komuna e Vushtrrisë, më datë 07.11.2025, ka shpallur Konkursin me numër reference RN00018969, për pozitën e punës *Zyrtar për Invalidë të Luftës dhe Familje të Dëshmorëve, Sektori i Shëndetësisë-Klasa Profesional 2*, me afat aplikimi nga data 08.01.2025 deri me datë 07.12.2025.
- Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 52 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, mirëpo, e njëjta më Vendimin numër protokolli 0515/26, të datës 06.01.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk posedon së paku një (1) vit përvojë pune profesionale pas diplomimit.
- Sipas Njoftimit me numër protokolli 5466/26, të datës 04.02.2026, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, rezultojnë se si kandidatë të suksesshëm janë shpallur N.L më gjithsej 85.60 pikë dhe T.S-U më gjithsej 78.20 pikë.

Pretendimet ankimore

Ankuesja kundërshton vendimin për refuzimin e aplikacionit, mbi pretendimet ankimore se organi i punësimit ka shkelur dispozitat e përgjithshme të procedurës administrative pasi që arsyetimit të vendimit i mungon arsyetimi lidhur me çështjen vendimtare që ka marrë për bazë me rastin e refuzimit të aplikacionit. Shton se organi administrativ nuk ka vërtetuar drejtë gjendjes faktike sepse sipas thënies në ankesë ankuesja ka dërguar të gjitha dëshmitë e përvojës së punës që rezultojnë të jenë më shumë se një vit dhe që kanë të bëjmë me punë administrative. Me tej, ankuesja shton se në konkursin gjegjes nuk ka qenë e përcaktuar që përvoja e punës duhet të jetë pas diplomimit. Kërkon që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet Vendimi me numër të protokollit 0515/26 i datës 06.01.2026, dhe të përfshihet në listën e ngushtë të kandidateve për vlerësim profesional.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë pretendimet

ankimore të ankueses si dhe veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e rekrutimit RN00018969. Andaj, në kontekst të këtij përcaktimi, Kolegji fillimisht ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit për pozitën e kontestuar dhe si rrjedhojë ka gjetur se si kriteret formale të përgjithshme formale janë vendosur: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor):Arsim i Lartë i Paspecifikuar; **Kërkesat Specifike:** Nuk ka. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. Gjegjësisht, sipas pikës 5 të konkursit si dokumente/dëshmi që kandidatet duhet të dorëzojnë më rastin e aplikimi janë përcaktuar: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës. ° Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; ° Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës. ° Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. ° Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushte.*

Në ndërlidhje me bazushmerinë e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 9 paragraf 1, ku përcaktohej se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj.*

- Nenit 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: 7. *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës..”*

-Neni 40: *Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas*

grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe nenin 6, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohej se: *2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, Kolegji i Këshillit ka analizuar dokumentacionin e ankueses të dorëzuar më rastin e aplikimit, nga dhe ka gjetur së e njëjta si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me numër 186, të lëshuar me datë 20.10.2020, nga Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” për përfundimin e studimeve në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike më datë 09.10.2020, ndërsa, sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës ankuesja ka bashkangjitur si dëshmi: Kontratën e marrëdhënies së punës në KQZ, numër 481/2025, e datës 09.10.2025, më kohëzgjatje prej datës 09.10.2025 deri me datë 30.11.2025, Kontratën e punës me numër 41, të datës 17.09.2019 e lidhur me Aleancën Kosova e Re “AKR”, në kohëzgjatje kohore 03.09.2019 deri 31.12.2019; dhe Kontratën e punës për kohë të pacaktuar e nënshkruar më datë 31.12.2019, e lidhur me Avokat Kada Bunjaku, më fillim nga data 01.01.2020, si bashkëpunëtor profesional. Pra, mbi gjendjen e këtyre fakteve rrjedhë së ankuesja nuk ka 1 vit përvojë punë pas diplomimit (datë 09.10.2020) rrjedhimisht, ankuesja në momentin e aplikimit më datë 27. 11.2025, ka pas përvojë punë në KQZ vetëm 1 muaj e 18 ditë, përvojat e punës në AKR për periudhën kohore 03.09.2019 deri 31.12.2019 ka të bëjë më periudhën para diplomimit, ndërsa, përvojën e punës tek avokatja Kada Bunjaku, ankuesja ka arrit të argumentoj më prova materiale gjegjësisht më Pasqyrë të Trustit vetëm për muajt janar, shkurt, mars, qershor dhe shtator 2020, periudhë kjo para diplomimit.

Lidhur me pretendimin e ankueses së konkursi nuk ka specifikuar se përvoja e punës duhet të jetë pas diplomimit, Kolegji konstaton së një pretendim i tillë nuk ka mbështetje ligjore, mbi faktin se përvojë pune profesionale konsiderohet vetëm përvoja pas diplomimit në studime themelore, përcaktim ky tashmë i konsoliduar më praktikën vendimmarrëse të Këshillit dhe i konfirmuar edhe nga gjykata (Aktgjykimet e Gjykatës Themelore A.nr.2276/2014 dhe A.nr.729/2016, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.367/2018, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ-AZVP nr.77/2019).

Andaj, duke u nisur nga fakti se ankuesja nuk ka dëshmuara së ka përvojë një vjeçare profesionale siç kërkohej më konkursin përkatës, Kolegji konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore më rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses më vendimin e kontestuar ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 39 paragrafi 7 dhe 8, ku përcaktohet se: *7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive*

profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi.

Po ashtu, Kolegji në vështrim të parimit të meritokracisë, si një nga parimet bazë për pranim në shërbim civil, ka analizuar dosjen e aplikimit të kandidatit fitues N.L (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë), duke konstatuar këtë gjendje faktike: posedon Diplomën me Nr.3154 të lëshuar me datë 11.04.2014, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për përfundimin e studimet më datë 27.02.2014 në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, Departamenti i Shkencave Politike, ndërsa, sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës së punës, kandidati në fjalë ka bashkangjitur si provë Vërtetimin me numër protokolli 38118 të datës 01.08.2025, të lëshuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/Komuna e Vushtrrisë, përmes së cilit dokument dëshmohej se i njëjti nga data 24.07.2024 deri me 24.07.2025 ka kryer praktike pune në administratën komunale të Komunash së Vushtrrisë/ në Zyrën për Integritet Evropian dhe në Zyrën Ligjore. Andaj, nisur kjo gjendje e fakteve rezulton se kandidati N.L ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkurs, e duke qenë së i njëjti ka arritur numrin më të madh të pikëve të vlerësimit, atëherë, më të drejtë institucioni gjegjës e ka shpallur si kandidat fitues për procedurën me numër reference RN00018969, siç përcaktohet me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër, e duke qenë se nuk janë evidentuar shkelje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00018969, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.186/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, E.P;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.